



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Kom.Dh.Shk.II.nr.1511/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbare të kreditorit ART SH.P.K., me numër unik identifikues 811511436, me seli në Fushë Kosovë, rr. “Shkolla Shqipe”, nr.29, me pronar G.S., i përfaqësuar nga A.H., avokat nga Fushë Kosova, kundër debitorit Prokuroria Themelore në Prizren, rr. Ëilliam Ëalker, Prizren, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm – faturës, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1596/22, të datës 29.09.2023, me datën 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit ART SH.P.K., me numër unik identifikues 811511436, me seli në Fushë Kosovë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1596/22, të datës 29.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje Ekonomike, KPPP.nr.1596/22, të datës 29.09.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Prokuroria Themelore në Prizren, dhe e ka anuluar urdhrin përmbare P.nr.140/22 i lejuar me datën 16.06.2022 nga Përmbaresi Privat Irfan I. Kërçagu, dhe e ka përfunduar në tërësi përmbaremin në këtë çështje përmbare.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbare, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që gjykata që lëndën ta anlizoje ta shqyrtoje dhe të e shikoje ekstraktin e ankesës, ose të ndryshojë aktvendimi ose çështjen dhe të njëjtën ta ktheje në rivendosje.

Debitori ka parashtruar përgjigje në ankesë, me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e kreditorit dhe aktvendimi KPPP.nr.1596/22 i datës 29.09.2023 të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, “ART” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor, P.nr.140/22 të datës 16.06.2022 me të cilin ka caktuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.10/2021 të datës 15.12.2021, me të cilin e ka obliguar debitorin që ti paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 350 (tre qind e pesëdhjetë euro), shpenzimet e avokatit për përpilimin e propozimit për përmbartim sipas rregullores për tarifën e avokatëve të vitit 2017 në vlerë prej 104 €, shpenzimet për përgjigje në prapësim sipas Rregullores për Tarifën e Avokatëve të vitit 2017 në vlerë prej 104 € si dhe të gjitha shpenzimet e tjera gjyqësore, kontestimore dhe procedurale që mund të rrjedhin gjatë procedurës sipas Rregullores për tarifën e avokatëve e të gjitha kërkesat ti vihen në barrë debitorit për pagesë me interesin në vlerë të kamatës prej 8 % në pajtimi me LMD-ën që nga data e paraqitjes së propozimit për përmbartim e deri në ditën e ekzekutimit të pagesës, shpenzimet për procedurën përmbartimore në përputhje me Udhëzimin Administrativ, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, me: ndalimin e mjeteve monetare të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë bankare të Përmbartuesit Privat, ndalimin e mjeteve në të ardhurat personal, regjistrimin vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, bllokimin e rentave dhe qirave të debitorit, deri në vlerën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor duke theksuar se formulari i kompensimit të shpenzimeve të ekspertëve nuk i përmban të gjitha elementet e detyrueshme, pasi që nuk është nënshkrimi i Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren. Shton se eksperti i prokurimit nuk është ekspert i licencuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, siç është e paraparë me dispozitat e Rregullores 15/2015 për Emërimin e Ekspertëve Gjyqësor e aprovuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, e cila ka qenë në fuqi në kohën kur kreditori ka qenë i angazhuar si ekspert. Tutje thekson se kreditori nuk ka legjitimitet, përkatësisht interes juridik në këtë çështje pasi që eksperti nuk është angazhuar si biznes për të kryer ekspertizën, për me tepër emri i ekspertit nuk figuron në vetë dëshmitë e dorëzuara nga kreditori në certifikatën e biznesit. Gjykatës i propozon të aprovohet prapësimi dhe të refuzohet urdhri përmbartimor apo të caktoj seancë ku do të vërtetohet se përmbartimi i lejuar është i pabazuar.

Kreditori në përgjigjen në prapësim, ka kundërshtuar thëniet e debitorit në prapësim, duke theksuar se janë të pabazuara dhe se të njëjtat duhet të refuzohen. I kërkon shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në vlerë prej 104 € duke i propozuar gjykatës se në rast se debitori ushtron ankesë ndaj vendimit të gjykatës, të obligohet që së pari ta paguaj garancionin konform nenit 78 të LPP-së.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të dispozitave të procedurës përbarimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin përbarimor P.nr.140/22, si dhe kur e ka përfunduar në tërësi procedurën. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se dokumenti i besueshëm-fatura, në bazë të cilit organi përbarues ka caktuar përbarimin, nuk i plotëson tiparet e përbarueshëmërisë.

Me Nenin 29 par.3 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP) është paraparë që për përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm *“është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.”*, po ashtu në paragrafin 1 përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*. Ndërsa me Nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se dokumenti i besueshëm, përkatësisht Fatura nr.10/2021, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e as vulën e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin me arsyet se urdhri për përbarim është lejuar mbi bazën e faturës të cilat jo vetëm se nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, por fatura nuk përmban as elementet për t’u cilësuar si faturë e rregullt apo dokument i besueshëm ngase mungon pranimi i rregullt dhe i nënshkruar nga e paditura.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se sipas shkresave tjera të lëndës, respektivisht aktvendimit të Prokurorisë Themelore të Prizrenit me numër PP/L.nr.54/2021 i datës 11.11.2011, për angazhimin e ekspertit të prokurimit z. F.Z. si dhe nga kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të ekspertëve, përkthyesve gjyqësor dhe profesionistëve tjerë në procedurat gjyqësore, e datës 15.12.2021, vërtetohet se F.Z. është caktuar ekspert, dhe se kërkesën e ka bërë në emër personal dhe jo si shpk kur e ka parashtruar të njëjtën, në Zyrën e Prokurimit të Prokurorisë Themelore në Prizren, dhe e njëjta është nënshkruar nga prokurori i rastit, por nuk është e nënshkruar nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, ndërsa

në faturën me të cilën është iniciuar procedura përbarimore e cila është cilësuar si dokument i besueshëm rezulton se është e nënshkruar nga F.Z. ndërsa mban vulën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Art Services”. Nga certifikata e regjistrimit të biznesit “ART Services” Sh.P.K., nuk figuron emri i ekspertit F.Z., andaj propozimi i parashtruar nga Art Sh.p.k, rezulton të jetë i mangët në cilësinë e legjitimitetit aktiv të palës. Për më tepër, Dhomat e Shkallës së Dytë gjejnë se edhe në anën e palës pasive në procedurë, debitori nuk ka legjitimitet për të qenë palë në procedurë, pasi që Prokuroria Themelore në Prizren nuk mund të jetë palë në procedura gjyqësore, pasi që nuk ka subjektivitet të vecantë juridik, por hyn në kuadër të rregullimit ligjor si njësi brenda Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Andaj, në rastin konkret kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përbarimin në bazë të dokumentit përbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përbarimin kundër debitorit dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Prandaj, mbi këtë bazë kjo gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur e ka kur e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin përbarimor P.nr.140/22, si dhe kur e ka përfunduar në tërësi procedurën.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1511/23, me datë 21.03.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova